



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 22 Dt. 13.02.2017

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “RAFAELO 2002” SH.A.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim të subjektit “**RAFAELO 2002**” sh.a, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore,Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**RAFAELO 2002**”sh.a, me administrator **Z.Eduart GJINAJ**, për përdorim të burimit ujor **Lumi i Gominës**, për prodhim energjie elektrike në Pukë, Qarku Shkodër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC GOMINA 1** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes ; X - 44 09 688; Y- 46 58 038; Z - +291 m
Koordinatat e godinës së centrali: X - 44 08 494; Y -46 60 099; Z - +210m;
Koordinatat e pikës së shkarkimit : X - 44 08 494; Y -46 60 099; Z - +210 m;
Prurja mesatare vjetore e burimit : $Q_{mes} = 1,662 \text{ m}^3/\text{sek}$;
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: $Q_{llog} = 1,612 \text{ m}^3/\text{sek}$;
Prurja ekologjike: $Q_{ekol} = 0.096 \text{ m}^3/\text{sek}$;
Prurja që shkarkohet: $1.612 \text{ m}^3/\text{sek}$.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari
Martin PLLUMBI



Kryetar
Paulin RADOVANI

